

**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE
BUJQËSORE**

ANALIZA E TREGUT TË DREDHËZËS

Tetor, 2020

Parathënie

Një ndër detyrat e Departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore është analizimi i tregut të produkteve të ndryshme bujqësore. Në këtë analizë pasqyrohet gjendja aktuale dhe trendet e zhvillimit të tregut të dredhëzës gjatë viteve. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj kulture mjaft fitimprurëse, përmes kësaj analize do të shtjellohen në

detaje të dhënat statistikore siç janë prodhimtaria vendore, eksporti dhe importi, çmimet e fermës, të konsumit dhe të importit, kostoja e prodhimit si dhe mbështetja me pagesa direkte dhe grante. Kjo analizë mundëson identifikimin e përparësive dhe mangësive për investime në kultivimin e kulturës së dredhëzës.

1 Tregu i dredhëzës

Kosova ka kushte të favorshme ekologjike për kultivimin e suksesshëm të dredhëzës. Dredhëza zë vend të rëndësishëm në grupin e pemëve të imta dhe interesimi i fermerëve për këtë kulturë është rritur nga viti në vit. Në periudhën e pas luftës, sipërfaqja e kultivuar me dredhëz ka qenë mjaft e vogël, por me kalimin e kohës, interesimi i fermerëve dhe mbështetja nga donatorët e huaj e po ashtu institucionet vendore për këtë kulturë rezultuan në rritje të vazhdueshme të sipërfaqes me dredhëz. Në vitin 2004, sipërfaqja ishte vetëm 14 ha, kurse në vitin 2019 është zgjeruar në 235 ha. Nëse analizojmë sipërfaqen për periudhën 2015-2019, vërejmë se sipërfaqja e mbjellë ka pasur ndryshime, ku

në vitin 2015 ishin 203 ha me dredhëz, pastaj në vitin 2016 dhe 2017 u zvogëlua sipërfaqja në 175 ha, për tu rritur sërish në vitin 2018 dhe 2019 në 235 ha.

Vetëdijesimi i fermerët për kultivimin e kulturës së dredhëzës paraqet një potencial për sigurimin e të ardhura familjare e po ashtu zbutje të papunësisë. Me rritje të sipërfaqeve të mbjella me dredhëz është rritur edhe konsumi i prodhimit vendor, që rezultoi në zëvendësim të një pjesë të importit dhe rritje të eksportit. Industria e përpunimit të dredhëzës po ashtu është zhvilluar në vitet e fundit duke arritur që eksporti ta tejkalon importin si me vlerë ashtu edhe sasi.

2 Prodhimtaria e dredhëzës


Prodhimtaria e dredhëzës ende nuk i përmbush nevojat e konsumit vendor e për këtë arsye pjesa tjetër vazhdon të importohet. Duke parë se kultivimi i kësaj kulture është treguar mjaft i leverdishëm dhe në përgjithësi fermerët janë të kënaqur me rendimentin e

dredhëzës, ata po i zgjerojnë vazhdimisht sipërfaqet e tyre, kështu duke e rritur prodhimin vendor e po ashtu eksportin. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2019, prodhimtaria vendore me dredhëz ka qenë 1,677 tonë, e krahasuar me vitin

paraprak, kishte rritje për 27%. Gjatë periudhës 2015-2019, prodhimtaria më e lartë ishte në vitin 2019 ndërsa rendimenti në këtë

vit ishte rreth 7 t/ha, i cili pati 27% rritje nga rendimenti i vitit 2018.

Figura 1: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i dredhëzës, 2015-2019



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3 Zhvillimi i tregtisë

Duke marrë parasysh që Kosova nuk i përmbushë plotësisht nevojat me dredhëz, Kosova vazhdimisht importon nga vendet fqinje si dhe më gjerë. Import të dredhëzës ka më shumë në raste kur në Kosovë nuk është koha adekuate për prodhimtari, ndërsa kur është sezona e prodhimit, Kosova edhe


eksporton sasi të mjaftueshme me dredhëz. Në periudhën 2015-2019 janë eksportuar mesatarisht rreth 57 tonë dredhëz e freskët dhe 57 tonë dredhëz e procesuar në vit, ndërsa janë importuar mesatarisht rreth 445 tonë dredhëz e freskët dhe 10 tonë dredhëz e procesuar në vit.

3.1 Importi i dredhëzës së freskët

Në figurën në vijim është paraqitur importi i dredhëzës së freskët sipas sasisë dhe vlerës për periudhën '15-'19. Nëse analizojmë importin sipas sasisë, vërejmë se nga viti 2015 deri në vitin 2019, sasia e importuar është rritur vazhdimisht. Në vitin 2019, sasia e importit të dredhëzës së freskët është më shumë se pesëfishi i sasisë së importuar të vitit

2015, ndërsa në krahasim me vitin 2018, është rreth 55% më e lartë. Sa i përket vlerës së importit, po ashtu vërehet një trend i rritjes gjatë periudhës në fjalë, ku vlera më e lartë ishte në vitin 2019, e kjo vlerë është katër herë më e lartë se e vitit 2015, dhe 48% më e lartë se viti paraprak.

Figura 2: Importi i dredhëzës së freskët sipas sasisë dhe vlerës, '15-'19




Burimi: MBPZHR - DAESB

Në figurën më poshtë është paraqitur sasia e importit të dredhëzës së freskët sipas shteteve për vitin 2018 dhe 2019. Sa i përket vitit 2018, sasia më e madhe është importuar nga Shqipëria (510 tonë), pasuar nga Serbia (20

tonë) dhe të tjera (15 tonë). Në vitin 2019, sasia më e madhe e importuar është po ashtu Shqipëria (663 tonë), pastaj Greqia (174 tonë) dhe shtetet tjera (7 tonë).

Figura 3: Sasia e importit të dredhëzës së freskët sipas vendeve për vitin 2018 dhe 2019




Burimi: MBPZHR - DAESB

3.2 Importi i dredhëzës së procesuar

Në figurën e mëposhtme vërejmë se importi i dredhëzës së procesuar ka pasur luhate gjatë viteve. Në vitin 2019 ka rënë për 6% krahasuar me vitin paraprak ku u importuan 12 tonë dredhëz e procesuar. Sa i përket figurës ku paraqitet importi në vlerë, shohim se nga viti

2015 deri në vitin 2019, vlera e importit vazhdimisht është rritur. Vlera më e lartë e shënuar e importit gjatë periudhës në fjalë ishte në vitin 2019 ku u importuan rreth 46,220 €.

Figura 4: Sasia e importit për dredhëzën e procesuar në tonë (majtas); Vlera e importit për dredhëzën e procesuar në '000 € (djathtas)




Burimi: MBPZHR - DAESB

Në figurën e mëposhtme është paraqitur sasia e importit të dredhëzës sipas shteteve për vitin 2018 dhe 2019. Sa i përket vitit 2018, sasia më e madhe është importuar nga Polonia (3.9 tonë), pasuar nga Serbia (2.2 tonë), Belgjika (1.3 tonë), Holanda (0.9 tonë) dhe të tjera. Edhe

në vitin 2019, Polonia është shteti prej nga është importuar më së shumti dredhëz e procesuar prej 3.9 tonë, dhe shtet tjera si Italia me 1.28, dhe Kroacia e Letonia me rreth 0.35 tonë.

Figura 5: Sasia e importit të dredhëzës së procesuar sipas vendeve për vitin 2018 dhe 2019



Burimi: MBPZHR - DAESB

3.3 Eksporti i dredhëzës së freskët


Meqenëse kultivimi i dredhëzës është rritur viteve të fundit, kjo ka ndikuar që të rritet konsumi i prodhimit vendor, të zëvendësohet një pjesë e importit dhe të rritet eksporti. Marrë parasysh edhe kushtet e favorshme

klimatike për kultivimin e saj, dredhëza paraqet potencial të madh për rritje të prodhimtarisë, e që do të ndikojë në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës dhe uljen e papunësisë. Eksporti i dredhëzës së

freskët gjatë periudhës 2015-2018, vazhdimisht ka shënuar rritje si nga sasia, ashtu edhe në vlerë. Në vitin 2019, eksporti

për këtë kulturë pësoi rënie për 13% krahasuar me sasinë e vitit 2018, ndërsa sa i përket vlerës, kishte rënie për vetëm 4%.

Figura 6: Sasia e eksportit i dredhëzës së freskët në tonë (majtas) dhe vlera në '000 € (djathtas)




Burimi: MBPZHR - DAESB

Figura më poshtë paraqet eksportin e dredhëzës së freskët sipas vendeve për vitin 2018 dhe 2019. Sa i përket sasisë së eksportuar, pjesa më e madhe e dredhëzës u eksportua në

Shqipëri. Në vitin 2018 një pjesë e vogël u eksportua në Serbi dhe vende të tjera, ndërsa në vitin 2019 kishte eksport të dredhëzës në Greqi dhe sasi shumë e vogël në vende të tjera.

Figura 7: Sasia e eksportit të dredhëzës së freskët sipas vendeve për vitin 2018 dhe 2019




Burimi: MBPZHR-DAESB

3.4 Eksporti i dredhëzës së procesuar

Gjatë periudhës '15-'19, Kosova ka eksportuar mesatarisht 57 tonë dredhëz të procesuar. Në vitin 2018 Kosova ka eksportuar më së shumti sasi të dredhëzës (141 tonë), ndërsa në vitin 2019 sasi pati rënie për 22% krahasuar me vitin

2018. Në anën tjetër, vlera e eksportit të dredhëzës së procesuar nga viti 2016 deri në vitin 2019 vazhdimisht ka pasur rritje, ku vlera më e lartë ishte 210 mijë €.

Figura 8: Sasia e eksportit i dredhëzës së procesuar në tonë (majtas) dhe vlera në '000 € (djathtas)




Burimi: MBPZHR - DAESB

Në figurën e mëposhtme vërejmë se në vitin 2018 dhe 2019, pjesa më e madhe e dredhëzës së procesuar është eksportuar në Serbi. Në vitin 2018, pjesa tjetër është eksportuar në

Greqi (20 tonë), ndërsa në vitin 2019, përveç Serbisë, një sasi me dredhëz u eksportua edhe në shtetin e Bosnjës (34 tonë), Francës (20 tonë), dhe Italisë (2.4 tonë).

Figura 9: Sasia e eksportit të dredhëzës së procesuar sipas vendeve për vitin 2018 dhe 2019





Burimi: MBPZHR - DAESB

3.5 Bilanci tregtar i dredhëzës

Në Kosovë ka një potencial të madh për rritje të prodhimtarisë së dredhëzës e kjo do të ndikojë në përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e vendeve të punës. Nëse analizojmë bilancin tregtar për dredhëzën e freskët për periudhën '15-'19 vërejmë se gjatë tërë periudhës, bilanci ishte negativ. Edhe pse ka pasur rritje të eksportit, importi është rritur

më shumë së eksporti. Sa i përket dredhëzës së procesuar, bilanci tregtar ka pasur luhatje gjatë periudhës në fjalë. Vetëm në vitin 2016 kishte bilanc negativ, kurse vitet tjera, sidomos vitet 2018 dhe 2019, eksporti ishte dukshëm më i lartë se importi, e si rrjedhojë, edhe bilanci ishte pozitiv.

Figura 10: Vlera e bilancit tregtar për dredhëzën e freskët (majtas) dhe dredhëzën e procesuar (djathtas)



Burimi: MBPZHR - DAESB

4 Çmimet e tregut

Kultura e dredhëzës në vendin tonë ka kërkesa të mjaftueshme dhe është mjaft profitabile prandaj plasimi i dredhëzës në treg nuk paraqet ndonjë problem për kultivuesit e saj. Sasia më e madhe nga kultivimi me dredhëz përdoret për shitje në


4.1 Çmimet në tregun vendor

Plasimi në treg i dredhëzës fillon nga muaji prill e zgjatë deri në muajin shtator, varësisht prej kushteve klimatike të cilat mundësojnë zhvillimin e kultivimit të kësaj kulture. Në figurën e mëposhtme janë të paraqitura çmimet vendore të fermës si dhe ato të konsumit të dredhëzës për periudhën '15-'19. Nëse analizojmë çmimet e fermës, vërejmë se në vitin 2019 ishte çmimi më i

tregun vendor ku kohëve të fundit kemi pasur edhe rritje të eksportit. Gjithashtu në tregun tonë dominojnë edhe prodhimet e importit për të përmbushur kërkesën gjatë mungesës së prodhimit vendor.

lartë i dredhëzës në vlerë prej 1.12 €, ndërsa ai më u ulëti ishte në vitin 2016, me çmim prej 0.88 €. Sa i përket çmimeve të konsumit, në figurën më poshtë janë të paraqitura si çmime të tregut me pakicë dhe shumicë. Gjatë periudhës '15-'19 kishte luhate të këtyre çmimeve. Viti 2017 dhe 2019 shënuan çmimet më të larta për periudhën në fjalë.

Figura 11: Çmimet e fermës për dredhëzën e freskët (majtas); Çmimet e tregut për dredhëzën e freskët (djathtas), '15-'19 (€/kg)




Burimi: MBPZHR - DAESB

4.2 Çmimet e importit

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur çmimet e importit me shumicë dhe pakicë për periudhën kohore '15-'19. Çmimet më të larta më shumicë dhe pakicë figurojnë në

vitin 2017, ndërsa më të ulëtat në vitin 2019. Çmimi mesatar me shumicë gjatë kësaj periudhe ka qenë 3.45 €/kg, kurse çmimi mesatar me pakicë ishte 3.80 €/kg.

Figura 12: Çmimet e importit me pakicë dhe shumicë për dredhëzën e freskët '15-'19(€/kg)



Burimi: MBPZHR - DAESB

5 Madhësia e tregut

Sipërfaqe e përgjithshme e mbjellur me pemë në vitin 2019 në Kosovë vlerësohet që ishte 9,479 ha, ndërsa nga totali i sipërfaqes me pemë, dredhëza merr pjesë me 2.4% me prodhimtari prej gjithsej 1,677 tonë. Prodhimtaria e dredhëzës mbulon rreth 69% të tregut vendor, ndërsa për të

përmbushur nevojat për konsum vendor, pjesa tjetër importohet. Përdorimi vendor duke përfshirë prodhimentarinë vendore dhe importin dhe duke përjashtuar sasinë e eksportuar, në vitin 2018 ka qenë 2,428 tonë, ku 1,677 tonë janë prodhimtari vendore, 844 tonë ishin dredhëza të

importuara ndërsa 93 tonë të eksportuara. Konsumi i përgjithshëm i dredhëzës në

Kosovë si mesatare për periudhën '15-'19 sillet rreth 900 gr për kokë banori në vit.

6 Kostoja e prodhimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat për dredhëzën gjatë tre viteve të prodhimit në sipërfaqe prej 10 ari, pasi që në Kosovë fermerët kultivojnë në kësi lloj sipërfaqesh më të tilla parametra. Gjithsej të ardhurat për dredhëzën në sipërfaqe prej 10 ari në fushë të hapur janë 4,373 € si mesatare për tri vite. Shpenzimet variabile arrijnë vlerën 1,420 € ndërsa marzha bruto 2,953 €. Në kalkulimet e paraqitura në tabelën e mëposhtme kostoja e fidanit është

llogaritur 0.05 € që paraqet koston e fidanit të cilin fermeri e përgatit vet, ndërsa në rast se fermeri blen fidanin vendor ai mund ta gjejë në treg me çmim mesatar rreth 0.12 €. Kjo do të ndikonte që të rritej kostoja e inputeve dhe automatikisht edhe të ardhurat neto do të ishin më të ulëta. Të ardhurat neto me subvencione për kulturën e dredhëzës sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme janë 2,553 € .

Tabela 1: Kostoja e prodhimit të dredhëzës

Kalkulimi i koston së prodhimit për dredhëzën, 2019				
Sipërfaqja: 10 ari në fushë të hapur				
Periudha: Mesatarja për 3 vite				
	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në €
TË ARDHURAT				
Dredhëz	kg	2,733	1.60	4,373.33
Gjithsej të ardhurat				4,373.33
KOSTO VARIABLE				
Gjithsej shpenzime për inpute				92.88
Gjithsej shpenzime të makinerisë				128.40
Gjithsej shpenzime të fuqisë punëtore				590.00
Gjithsej shpenzime të tjera				608.81
Gjithsej shpenzime variabile				1,420.10
MARZHA BRUTO				2,953.24
Zhvlerësimi				440.07
TE ARDHURAT NETO				2,513.17
Subvencione				40.00
TË ARDHURAT NETO+Subvencionet				2,553.17

Burimi: MBPZHR

7 Mbështetja e prodhimitarisë së dredhëzës

7.1 Pagesat Direkte

Programi i pagesave direkte është ndër shtyllat kryesore të mbështetjes që jep shteti për fermerët e vendit tonë. Arsyeshmëria e zbatimit Objektivat që tentohen të arrihen përmes pagesave direkte për kulturën e dredhëzës janë: sigurimi dhe siguria e ushqimit rritja e të hyrave në fermë, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqes, ndalimi i migrimit nga zonat rurale në zonat urbane, etj. Objektivat e përgjithshme dhe specifike për këtë kulturë janë: rritja e të hyrave në fermë, përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor, mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese, zvogëlimi i kostos së prodhimit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, rritja e rendimentit dhe intensifikimi i

ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Fermerët të cilët kanë synim kultivimin e kulturës së dredhëzës duhet që t'i plotësojnë kriteret në vijim: të kenë të mbjellur së paku 0.20 ha, parcela e mbjellur me dredhëz duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë, si dhe sipërfaqja me dredhëz e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë. Pemishtja e mbjellur me dredhëz duhet të jetë e mirëmbajtur (me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) gjithashtu duhet pasur parasysh që sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt në mes rendeve dhe rreshtave. Subvencionimi bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej 400 €/ha.

7.2 Masat e zhvillimit rural që e përkrahin sektorin e pemëve - Dredhëzën

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2019 dredhëza është mbështetur në kuadër të masës 101, Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore, nënmasa "Sektorin e perimeve dhe serrave" për ndërtimin e serrave të përhershme për prodhimin e pemëve manore si dhe ndërtimin e depove për trajtim pas vjeljes dhe ruajtjen e pemëve. Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë përmirësimi i aftësisë konkurruese dhe zëvendësimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e fermerëve me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së,

përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial përmes zhvillimit të kapitalit fizik dhe adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme. Objektivat specifike që kanë të bëjnë me sektorin e pemëve janë: rritja e prodhimit të pemëve për qëllime komerciale; përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së; modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizmit modern; zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për

fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim; prodhimi i energjisë së ripërtëritshme dhe përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve bujqësore. Për të përfituar përmes kësaj mase fermerët duhet që përveç kritereve të përgjithshme që shpallen në thirrjen për aplikim ata duhet të plotësojnë edhe disa kritere specifike për sektorin e pemëtarisë dhe serrave. Aplikuesit në momentin e aplikimit për investime, duhet të dëshmojnë se kanë së paku 2 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marr me qira për së paku 10 vjet. Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 hektarë tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave. Madhësia minimale e një serre e pandarë është 10 ari. Investimet e pranueshme për këtë sektor janë: Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për pemë manore apo fidanë (sipërfaqja minimale e një serre është 0.1 hektar); Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtëritshme; Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra; Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes; Ndërtimi i objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale; Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e pemëve manore në fushë të hapur apo në serra (makinë për

mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.) Sa i përket shkallës së përkrahjes publike, kushtet janë si në vijim: Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 3,000 €; Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000 €; Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit; Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç ose më të rinj në momentin e aplikimit); Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për Masën 101 është 400,000 € për përfitues; Aplikuesi mund të aplikoj me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur. Buxheti për nënmasën për serra dhe depo për ruajtje të perimeve dhe pemëve manore për vitin 2019 është 3,500,000 €. Përveç masës 101, dredhëza përkrahet edhe në kuadër të masës 103, Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. Kjo masë ka për qëllim që të rrisë konkurrueshmërin e sektorit agroushqimor, të ndikoj në zëvendësimin e produkteve të importuara si dhe përmirësimin e produktivitetit. Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë përmirësimi i aftësisë konkurruese përmes rritjes së produktivitetit dhe përdorimit të

teknologjive të reja, përkrahja e bujqve me qëllim të përafrimit me standardet e BE-së dhe përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, forcimi i lidhjeve me prodhimin primar dhe prodhimi i energjisë së ripërtëritshme me qëllim të ruajtjes së mjedisit si dhe përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave. Objektivat specifike të kësaj mase janë: implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së, përmirësimi i teknologjive të prodhimit si dhe objekteve përcjellëse, diversifikimi i prodhimeve, përmirësimi i marketingut dhe përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve. Përfitues në kuadër të kësaj mase mund të jenë vetëm ndërmarrjet të vogla dhe të mesme që kategorizohen sipas legjislacionit në fuqi. Përfituesit e mundshëm janë subjektet që kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku dy vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ndërsa në rast të investimit në qendra grumbulluese dhe paketuese kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 1,000 m³ të prodhimit. Në rast të zgjerimit të objektit ekzistues ky objekt duhet të ketë kapacitet minimal prej 500 m³, ndërsa objekti i zgjeruar duhet të arrijë kapacitetin minimal 1000 m³. Investimet e pranueshme për dredhëzën në kuadër të kësaj mase janë: Investimet në ndërtim, zgjerim, rinovim të objekteve për përpunim; Investimet në linja për konservim; Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve; Investimet në objekte dhe

pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për deponim; Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara; Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës; Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit; Investimet për pajisje për kontrollë të cilësisë përfshirë laboratorët përkatës; Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje; Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontrollë dhe menaxhim; Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Në kuadër investimeve të pranueshme për dredhëz hynë edhe shpenzimet e marketingut siç janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, etj., për promovim të produkteve, por jo edhe për shpërndarje të tyre; prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale; vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €; shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €. Vlera minimale e pranueshme për projekt është 30,000 € ndërsa vlera maksimale 400,000 €. Përkrahja publike është në nivelin 50% të

shpenzimeve të pranueshme të investimit, ndërsa vetëm për investimet që kanë të bëjnë me trajtimin e mbetjeve përkrahja rritet në 60%. Pagesa bëhet me dy këste ku pjesa e parë prej 50% jepet në formë të

paradhënies pas nënshkrimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër pas përfundimit të investimit të përgjithshëm. Në total për përkrahje të pemëve dhe perimeve në kuadër të kësaj mase janë ndarë 1,200,000 €.

8 Konkluzione dhe Rekomandime

Nga të dhënat e paraqitura në këtë analizë arrijmë në përfundim se sipërfaqja e kultivuar me dredhëz vazhdimisht ka qenë në rritje e sipër, e po ashtu ka pasur rritje të eksportit viteve të fundit. Mirëpo, përkundër zgjerimit të sipërfaqes, për t'i plotësuar nevojat vendore, Kosova vazhdimisht ka importuar dredhëz si produkt i freskët dhe i procesuar. Krijimi i kushteve të avancuara për kultivimin e kulturës së dredhëzës dhe po ashtu rritja e sipërfaqes së mbjellur me dredhëz shihet si një ndër prioritete për vitet në vijim. Kultivimi i dredhëzës mundëson dhe realizon të ardhura të mira për ekonominë

bujqësore, ofron rikthim të shpejtë dhe profitabil të investimit, gjeneron vende të reja të punës si dhe kontribuon në ekonominë e përgjithshme të vendit. Prandaj, përveç mbështetjes në nivel qendror përmes subvencioneve dhe granteve, nevojitet t'iu ofrohet fermerëve përkrahje edhe nga niveli komunal. Disa nga sfidat për prodhuesit vendor që kultivojnë dredhëzën janë sigurimi i materialit cilësor fidanor, mungesa të kapaciteteve përpunuese në vend dhe vështirësitë e hasura përgjatë zinxhirit të vlerës.

